

5 tetor 2007

Komunikatë për media

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën 29 të Privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) zyrtarisht shpalli valën 29 të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 11 shtator, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitatet përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet www.kta-kosovo.org.

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës së 29-të janë përfshirë 8 Ndërmarrje Shoqërore (NSH), nga të cilat janë krijuar 10 Ndërmarrje të Reja.

8 Ndërmarrje Shoqërore do të privatizohen përmes spin-off-it të rregullt, nga të cilat janë krijuar 9 Ndërmarrje të Reja.

1 Ndërmarrje Re e krijuara nga 1 Ndërmarrje Shoqërore është në dispozicion përmes spin-off-it special.

Afati për para-kualifikim është deri me 05 dhjetor 2007.

Dita për dorëzimin e ofertave është me 12 dhjetor 2007.

Lista e plotë e Ndërmarrjeve të Reja të shpallura në këtë valë:

Ndërmarrja e Re “Toka Bujqësore në Prelez” Sh.P.K. - ky tender ofron mundësinë të blej një pronë me sipërfaqe tokësore përafërsisht 31 ha, në një vend i cili ka potencial për zhvillim bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes së Re gjendet afër fshatit Prelez në veri të Ferizajt dhe afër rrugës kryesore Prishtinë - Shkup, afër fshatit Elezaj. Momentalisht gjendet kështu. Momentalisht është dhënë në shfrytëzim si livadh për kultivim sane për bagëti.

Ndërmarrja e Re “Toka Bujqësore në Varosh” Sh.P.K. - ky tender ofron mundësinë të blej një pronë me sipërfaqe tokësore përafërsisht 46 ha, në një vend i cili ka potencial për zhvillim bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes së Re gjendet afër fshatit Varosh afërsisht 3 km në jug të Ferizajt. Momentalisht është dhënë në shfrytëzim si livadh për kultivim sane për bagëti.

Ndërmarrja e Re “Toka Bujqësore në Komoglavë” Sh.P.K. - ky tender ofron mundësinë të blej një pronë me sipërfaqe tokësore përafërsisht 56 ha, në një vend i cili ka potencial për zhvillim bujqësor dhe komercial. Toka e Ndërmarrjes së Re gjendet në jug të KFOR-it Grek, është në hyrjen kryesore të rrugës për në kampin Bonsteel dhe gjendet afërsisht 5km nga Ferizaj dhe ½ km nga rruga kryesore Prishtinë – Ferizaj – Shkup. Toka momentalisht kultivohet nga bujqit qiraxhinj kryesisht për grurë dhe afro 2 hektarë janë livadh.

Ndërmarrja e Re Dygani Banana i Çyçavicës në Vushtri Sh.P.K. - gjendet në qendër në Vushtri në anën e kundërt të Shtëpisë së Mallrave dhe përfshin një hapësirë dhe ndërtesë me një sipërfaqe përrreth 36 m² (36 m²).

Ndërmarrja e Re Ndërtesa e Administratës e Ekonomisë së Pyjeve – Vushtrri Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial mundësinë ideale për të përfituar rreth 9253 m² (92are 53m²) toke ,duke perfshire ndërtesën me sipërfaqe prej 200m² , dhe tokë të punueshme me sipërfaqe prej 9053 m² , te përshtatshme për qdo llojë veprimtarie.

Ndërtesa dhe toka gjenden në një lokacion shumë të përshtatshëm,në afërsi të qendrës së Vushtrrisë.

Ndërmarrja e Re Ndërtesa Administrative dhe Toka Bujqësore Rakosh Sh.P.K. - i ofron investitorit tokë të pjellshme bujqësore me siperfaqe prej afro 73 ha dhe ndërtesa administartive. Ndër. e Re gjendet afër Istogut.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Drenovc Sh.P.K. - i ofron investitorit potencial të blejë tokë bujqësore me sipërfaqe prej 240 ha.në fshatin Drenovc në rrugën kryesore Pejë-Prishtinë.

Ndërmarrja e Re Urata Supermarketi No. V Sh.P.K. - i ofron mundësi të shkëlqyeshme investitorit potencial për përfitimin e një prone afariste me përafërsisht 173 m² (dhe podrum me përafërsisht 15 m²) në lokacion kyç në qendër të Prishtinës. Prona gjendet në katin përdhësë të ndërtesave për banim në sheshin Zahir Pajaziti - Bulevardi Nëna Terezë përballe Hotel Grand.

Ndërmarrja e Re Mekanizimi Ferizaj Sh.P.K. - ofron investitorëve potencial mundësinë që të fitojë pronë afariste në Ferizaj që përfshinë hapësirë depoje/zyre (përafërsisht 448 m²) me pishinë të motorizuar (përafërsisht 2,863m²), të gjitha me sipërfaqe prej përafërsisht 3, 311m² (33 ari dhe 11 m²).

Dita e fundit për parakualifikim është: 05 dhjetor 2007

Dita për dorëzimin e ofertave është: 12 dhjetor 2007

Spin-off Special

Ndërmarrja e Re Morava e Binçës Gurëthyesi Sh.P.K. - ky tender i ofron investitorit mundësinë për të blerë një nga gurëthyesit më të mëdhenj në Kosovë që gjendet në periferi të qytetit të Gjilanit. Prona, lëndë e këtij tenderi ka një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 1,430,861m² tokë (143 ha 08 ar 61 m²) duke përfshirë objekte të ndryshme me rreth 3,200 m² . Përveç pajisjeve për biznesin kryesorë të gurëthyesit (kapaciteti rreth 300 m³/h) ekziston edhe baza e prodhimit te asfaltit me dy linja prodhuese (kapaciteti rreth 90 Tonelata /h) si dhe makineri për prodhimin e produkteve te ndryshme nga betoni i presuar.

Dita e fundit për parakualifikim është: 05 dhjetor 2007

Dita për dorëzimin e ofertave të para është: 12 dhjetor 2007

Dita për dorëzimin e ofertave të dyta është: 19 dhjetor 2007